

Important notice on new measures taken by the Albanian government to prevent the infection and spread of COVID-19

As of July 15th 2020, the Albanian Council of Minister in the ambit of fighting and further preventing the spread of Covid-19 decided to make an addition to the Normative Act No. 3 Dated, 15.03.2020 "On the adoption of special administrative measures for the duration of the period of infection caused by COVID-19".

Most specifically changes were made to Article 3 with the addition of Point 23, which states as follows:

In closed public and commercial environments, a protective barrier (**mask**) should be used, according to the definitions made in the instruction of the Institute of Public Health, approved by the minister responsible for health. Failure to use the protective barrier (mask) by individuals indoors of public and commercial areas, is punishable by a fine of 2,000 (two thousand) ALL.

The institutions responsible for the implementation of the same are the inspectorates responsible according to their area of responsibility for individuals in public and commercial premises, while the State Police and the Municipal Police are responsible for individuals in public transport and other facilities determined by joint instruction of the minister responsible for health and the minister responsible for order and safety.

Based on the above the new additions to the Normative Act are immediately too be considered in force, as a result all citizens are required to wear protective masks indoors of public or commercial areas.

Njoftim i rëndësishëm për masat e reja të marra nga qeveria shqiptare për të parandaluar infeksionin dhe përhapjen e COVID-19

Që nga 15 korriku 2020, Këshilli i Ministrave në kuadër të luftës dhe parandalimit të mëtejshëm të përhapjes së Covid-19 vendosi të miratojë një shtesë në Aktin Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19"

Më konkretisht janë bërë ndryshime në Nenin 3 me shtimin e pikës 23 e cili përcakton si më poshtë:

Në ambiente të mbyllura publike dhe tregtare duhet të përdoret barrierë mbrojtëse (**maskë**), sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Mospërdorimi i barrierës mbrojtëse (maskë) nga individët në ambiente të mbyllura, publike dhe tregtare, dënohet me gjobë në masën 2,000 (dy mijë) lekë.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj pike janë inspektoratet përgjegjëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë për individët në ambientet publike dhe tregtare, ndërsa Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për individët në transportin publik dhe në mjedise të tjera të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë.

Bazuar në sa më sipër, shtesat e reja në Aktin Normativ mund të konsiderohen si të menjëhershme dhe si rezultat të gjithë qytetarëve u kërkohet të veshin maska mbrojtëse në ambiente publike ose komerciale të mbyllura.